

Kryetari i Komunës


Nr. 22-17784-0051136/76 dt. 24.08.26
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Kërkesën elektronike nga znj. Arta Azemi, Shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës të datës 25.08.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Komisionit për verifikimin e gjendjes faktike në objektet shkollore në Komunën e Mitrovicës së Jugut)

- Formohet** Komisioni për verifikimin e gjendjes faktike në objektet shkollore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Dea Kerleshi - kryetare, Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm;
 - 1.2. Bahri Sinani – anëtar, Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit;
 - 1.3. Agon Bytyqi - anëtar, Drejtoria Komunale e Arsimit;
 - 1.4. Artan Ibishi – anëtar, Drejtoria e Inspektionit;
 - 1.5. Ardian Brahimi – anëtar, Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm.
- Detyrë e Komisionit të lartcekur është verifikimi i gjendjes faktike në shkollat e Komunës së Mitrovicës së Jugut, respektivisht gjendja inventarit dhe kushteve të domosdoshme për fillimin dhe vijueshmërinë e procesit mësimor si: gjendja e nyjeve sanitare, inventari, dyert dhe dritaret në këto shkolla.
- Komisioni obligohet që pas kryerjes së punës të përpilojë Raport me Shkrim për secilin nga shkollat e inspektuara lidhur me këtë proces, të cilin ja paraqet Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Drejtorisë së Arsimit dhe Kryetarit të Komunës.
- Mandati i Komisionit do të zgjas nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi gjerë në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Faton PEÇI

Shtojcë:

1x1 Kërkesa elektronike e datës 25.08.2026 nga znj. Arta Azemi- Shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës.

T'i dorëzohet:

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm
1x1 Drejtorisë së Arsimit
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit